



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.69 dt.08.05.1998

**MBI SHQYRTIMIN E ANKESAVE PER DHENIE TE LEJES  
SE NDERTIMIT NGA K.RR.T.-ja**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.08.05.1998, pasi shqyrtoi shkresat e ardhura nga Prefektura e Tiranës si dhe ankesat e qytetarëve të tjerë, duke u mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” si dhe ligjin Nr.8015, dt.19.10.1995 “Për disa ndryshime”, në ligjin Nr.7693, dt.26.04.1993 “Për Urbanistikën”,

**V E N D O S I**

1. Ankesa lidhur me lejen e dhënë J.Prifirit me pronar toke Z.Ollga Elini në Rr.”Barrikadave”.  
Të mos i rinovohet leja nga K.RR.T.
2. Ankesa lidhur me lejen e K.RR.T. Nr.546, dt.25.11.1997, Rr.”Ferit Xhajko”.  
Nuk është problem për Komisionin e Zhvillimit Urban dhe Këshillit Bashkiak.
3. Ankesa nga banorët e Pall. Nr.9,10 Rr.”Emin Duraku”.  
Çështja është në proces gjyqësor, i cili do të zgjidhë problemin.
4. Ankesa lidhur me ndërtime në terrenet e pallateve “Agimi”.

Ndërtimi ka filluar, nuk i përket Komisionit të Zhvillimit Urban.

5. Ankesa për një ndërtim pranë shkollës “Qemal Stafa”.  
Nuk ka shkelje urbanistike, mbetet në fuqi vendimi i K.RR.T.
6. Ankesa e ripërsëritur për ndërtimin e familjes Qinami në Rr.”Zonja Çurre”.  
Çështja është në proces gjygjësor.
7. Ankesa e banorëve përreth pasazhit që të çon në Rr.e “Durrësit” në qendrën Engleze të informacionit, lidhur me lejen e K.RR.T. Nr.540, dt.16.10.1997, e cila lejon mbylljen e tij. Të riparqitet në K.RR.T.
8. Ankesa lidhur me mosrespektimin e kushteve urbanistike nga firma “Beqo” për ndërtimin në Rr.”Mihal Duri”. Çështja nuk i takon Këshillit Bashkiak.
9. Ankesa nga familja Nikolin Kolenica për mos dhënien e lejes së ndërtimit. Nuk miratohet, sepse nuk përmbush kushtet urbanistike. Mbetet në fuqi vendimi i K.RR.T.
- 10.**Zbatimi i Vendimit të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**